

# **Rregullore Kodifikimi në Sistemin Elektronik të Tregtimit në Bursën Shqiptare të Titujve ALSE**

Miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.15, datë 23.03.2018

Ndryshuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr.22, datë 22.11.2018

Hyrë në fuqi në bazë të vendimit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Finaciare nr. 80 datë 24.04.2019 mbi ndryshimet në Rregulloren nr. 120 datë 02.10.2008 **“Për Licencimin dhe Mbikëqyrjen e Bursës së Titujve”** dhe shkresës nr.

Prot. 1480 datë 06.05.2019 mbi ndryshimet e Rregullores nr. 120

## Tabela Përmbledhëse

KAPITULLI I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME .....	3
Neni 1 Përkufizime .....	3
Neni 2 Objekti i rregullores .....	3
Neni 3 Baza Ligjore .....	3
Neni 4 Mënyra e Kodifikimit .....	4
KAPITULLI II KODIFIKIMI I PJESMARRËSVE NË ETS.....	4
Neni 5 Kategoritë e Anëtarëve.....	4
Neni 6 Kodifikimi i Anëtarëve .....	4
Neni 7 Kategoritë e Vëzhguesëve të Jashtëm të Tregut .....	4
Neni 8 Kodifikimi i Mbikëqyrësit të Jashtëm të Tregut dhe Vëzhguesve të tjerë.....	5
Neni 9 Kodifikimi i Brokerave Fizikë.....	5
Neni 10 Mënyra e Kodifikimit të Emetuesve.....	6
KAPITULLI III KODIFIKIMI I TITUJVE.....	6
Neni 11 Kategoritë e Titujve .....	6
Neni 11/1 Struktura e Kodifikimit të Titujve>>>>>>>> .....	6
Neni 12 Kodifikimi i Titujve të Borxhit.....	7
Neni 13 Mënyra e kodifikimit të Titujve të Kapitalit.....	9
KAPITULLI IV KODIFIKIMI I LLOGARIVE TË TREGTIMIT .....	10
Neni 14 Kodifikimi i Llogarive të Tregtimit .....	10
KAPITULLI V KODIFIKIMI I SKEDULIT TË ORARIT TË TREGTIMIT .....	10
Neni 15 Kodifikimi i skedulit të tregtimit.....	10
KAPITULLI VI KODIFIKIMI I ÇERTIFIKATAVE TË PËRDORUESVE TË SISTEMIT ETS.....	11
Neni 16 Kodifikimi i Çertifikatës së Anëtarësimit në Bursën ALSE .....	11
Neni 17 Kodifikimi i Çertifikatës së Përdoruesit të Sistemit ETS .....	11
Neni 18 Kodifikimi i Çertifikatës së Mbikëqyrësit të Tregut.....	11
Neni 19 Kodifikimi i Çertifikatës së Vëzhguesve të Tregut .....	12
Neni 20 Hyrja në Fuqi.....	12

# KAPITULLI I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

## Neni 1

### Përkufizime

- a) **Anëtar** – Në bazë të Rregullores së ALSE Anëtar është çdo person juridik i Anëtarësuar në ALSE;
- b) **ALSE** – Bursa Shqiptare e Titujve ALSE;
- c) **Broker** – Një person fizik i licensuar nga AMF në bazë të ligjit nr. 9879, datë 21.2.2008 "Për Titujt", i cili punësohet nga një Anëtar dhe autorizohet prej tij për të vepruar si personi përgjegjës për tregtimin në emër të Anëtarit që e ka caktuar dhe të klientëve të këtij Anëtar;
- d) **Emetues** - Çdo person juridik, Titujt e të cilit (ose çdo klasë titujsh) janë pranuar ose i nënshtrohen një aplikimi për t'u pranuar në listim dhe/ose kuotim në ALSE;
- e) **Llogari Klienti** – Llogaria në të cilën brokeri tregëton për llogari të klienteve të Anëtarit;
- f) **Llogari House** - Llogaria në të cilën brokeri tregëton për llogari të Anëtarit që përfaqëson;
- g) **Mbikqyrësi i Tregut** - Është autoriteti (në këtë rast Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare) që do të mbikëqyrë veprimet që do të kryhen në Bursën ALSE;
- h) **Sistemi Elektronik i Tregimit (ETS)"** - Është platforma elektronike e tregimit që kryen tregtimin (përputhjen e urdhrave) e të gjithë Titujve të kuotuar në ALSE, sic parashikohet në Rregulloren e ALSE;
- i) **Shoqëri Komisionere** – Çdo Person Juridik që është i licencuar nga AMF për të ushtruar aktivitetin në tregun e Titujve, në përputhje me ligjin nr. 9879, datë 21.2.2008 "*Për Titujt*";

## Neni 2

### Objekti i rregullores

Objekti i kësaj rregulloreje është krijimi i standardeve dhe rregullave për mënyrën e kodifikimit në Sistemin ETS të:

- Anëtarëve të ALSE,
- Mbikëqyrësve dhe Vëzhguesve të jashtëm të tregut,
- Brokerave Fizikë,
- Emetuesve, titujt e të cilëve do të listohen në ALSE,
- Titujve që do të listohen në ALSE,
- Llogarive të tregimit,
- Çertifikatave të Përdoruesëve të ETS,
- Skedulit të tregimit,

## Neni 3

### Baza Ligjore

Hartimi i kësaj rregullore bazohet në:

- Ligjin nr.9879 "Për Titujt" miratuar më 21.02.2008,
- Rregulloren mbi Liçencimin dhe Mbikëqyrjen e Bursës së Titujve nr.173, ndryshuar më 31.10.2016,
- Rregulloren e Bursës Shqipëtare të Titujve ALSE.

## Neni 4

### Mënyra e Kodifikimit

Mënyra e kodifikimit në Sistemin ETS e përcaktuar në këtë rregullore përfshin përdorimin e shkronjave, simboleve dhe shifrave.

Shkronjat do të jenë sa më të përafërta me markën tregtare të personit juridik që përfaqësojnë. Gjithashtu shkronjat për personat fizikë do të tregojnë shkallën e eksperiencës (Senior dhe Junior).

Shifrat do të jenë përfaqësuese të numrit rendor rritës.

## KAPITULLI II KODIFIKIMI I PJESMARRËSVE NË ETS

### Neni 5

#### Kategoritë e Anëtarëve

Anëtarët të cilët do të regjistrohen dhe do të operojnë nëpërmjet brokerave të tyre në sistemin elektronik të tregtimit do të jenë:

- a) Bankat,
- b) Shoqëritë Komisionere jo banka.

### Neni 6

#### Kodifikimi i Anëtarëve

Mënyra e kodifikimit të Anëtarëve pjesmarrës në sistemin ETS do të bëhet sipas kategorive të përmendura më poshtë:

#### 1) Bankat

Kodifikimi i çdo Anëtari "**Bankë**" do të përmbajë shkronjen "B" në fillim të kodit që do të përfaqësojë termin "Bankë" dhe do të shoqërohet më pas me 3 deri në 4 shkronja të cilat do të përfaqësojnë shkurtimin e emrit të markës tregtare të Anëtarit.

*Shembull: "B-CRD" do të përfaqësojë shkurtimin e markës tregtare të Credins Bank.*

#### 2) Shoqëritë Komisionere jo Banka

Kodifikimi i Anëtarëve "**Shoqëri Komisionere jo Bankë**" do të përmbajë në fillim të kodit shkronjën "**S**" që do të përfaqësojë termin "Shoqëri Komisionere" dhe më pas 3 deri në 4 shkronja që do të përfaqësojnë shkurtimin e emrit të markës tregtare të Anëtarit.

*Shembull: "S-PRD" do të përfaqësojë shkurtimin e markës tregtare të Prodata.*

### Neni 7

#### Kategoritë e Vëzhguesëve të Jashtëm të Tregut

Vëzhguesit jashtëm të Tregut të ALSE do të ndahen në 2 kategori kryesore në bazë të llojit të informacionit që do t'u vihet në dispozicion:

- a) **Mbikëqyrësi i Jashtëm i Tregut** – do të jetë "Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare",
- b) **Vëzhguesit e tjerë të jashtëm** – do të jenë mbikëqyrës nga Bankat e Nivelit të dytë dhe/ose nga Kompani të tjera lidhura me ALSE.

## Neni 8

### Kodifikimi i Mbikëqyrësit të Jashtëm të Tregut dhe Vëzhguesve të tjerë

- 1) Kodifikimi i Mbikëqyrësit të jashtëm të Tregut do të jetë i përbërë në 2 pjesë në të cilin pjesa e parë do të përfaqësojë shkurtimin e emrit të mbikëqyrësit të jashtëm dhe pjesa e dytë do të japë informacion lidhur me përdoruesin. Kodifikimi në këtë rast do të jetë si më poshtë:
- Emri i plotë do të jetë **“AMF-OnJ/S”**
  - **“AMF”** do të përfaqësojë shkurtimin e emrit të mbikëqyrësit të tregut në këtë rast **“Autoritet i Mbikëqyrjes Financiare”**,
  - **“O”** do të përfaqësojë kodifikimin për termin “Observer” (Vëzhgues),
  - **“n”** do të përfaqësojë numrin rendor të përdoruesit,
  - **“S”** do të përfaqësojë statusin **“Senior”** dhe **“J”** statusin **“Junior”** të përdoruesit, ku statusit që do të kenë statusin **“Senior”** do të kenë akses të plotë në sistem, ndërsa përdoruesit që do të kenë statusin **“Junior”** do të ketë akses të limituar.

*Shembull: “AMF-O2S” (Përdoruesi i dytë senior i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare)*

- 2) Kodifikimi i Vëzhguesve të tjerë të jashtëm të tregut do të jetë i përbërë në 2 pjesë në të cilin pjesa e parë do të përfaqësojë shkurtimin e emrit të vëzhguesit dhe pjesa e dytë do të japë informacion lidhur me përdoruesin. Kodifikimi në këtë rast do të jetë si më poshtë:
- Emri i plotë do të jetë **“KMP-OnJ/S”**
  - **“KMP”** do të përfaqësojë shkurtimin e emrit të vëzhguesit në këtë rast **“Kompania”**,
  - **“O”** do të përfaqësojë kodifikimin për termin “Observer” (Vëzhgues),
  - **“n”** do të përfaqësojë numrin rendor të përdoruesit,
  - **“S”** do të përfaqësojë shkurtimin e termit **“Senior”**,
  - **“J”** do të përfaqësojë shkurtimin e termit **“Junior”**.

*Shembull: “SCAN-O3S” (Brokëri i tretë senior i Televizionit SCAN)*

## Neni 9

### Kodifikimi i Brokerave Fizikë

Kodifikimi i Brokerave Fizikë të cilët do të tregtojnë në Bursën ALSE nëpërmjet sistemit ETS do të jetë i përbërë nga 2 pjesë, në të cilin pjesa e parë do të përfaqësojë shkurtimin e emrit të Anëtarit dhe pjesa e dytë do të japë informacion lidhur me përdoruesin.

Brokërat që do të operojnë në sistemin ETS do të do të kodifikohen sipas mënyrës së mëposhtme :

Në rastin e një Brokëri që operon për një Bankë:

- Kodi i plotë do të jetë **“B-BNK-BnS”**
- **“B-BNK”** do të përfaqësojë shkurtimin e emrit të Anëtarit për të cilin Brokëri operon (bazuar në Nenin 6/1),
- **“BnS”** në të cilën **“B”** do të përfaqësojë shkurtimin e termit **“Broker”**,
- **“n”** do të përfaqësojë numrin rendor të Brokërit përdorues,
- **“S”** do të përfaqësojë shkurtimin e termit **“Senior”**
- **“J”** do të përfaqësojë shkurtimin e termit **“Junior”**.

*Shembull: “B-ABI-B1S” (Brokëri i parë senior i ABI Bank)*

Në rastin e një Brokeri që operon për një Shoqëri Komisionere jo Banka:

- Kodi i plotë do të jetë **“S-PDT-BnS”**
- **“S-PDT”** do të përfaqësojë shkurtimin e emrit të Anëtarit për të cilin Brokeri operon (bazuar në Nenin 6/2),
- **“B”** do të përfaqësojë shkurtimin e termit **“Broker”**,
- **“n”** do të përfaqësojë numrin rendor të Brokerit përdorues,
- **“S”** do të përfaqësojë shkurtimin e termit **“Senior”**,
- **“J”** do të përfaqësojë shkurtimin e termit **“Junior”**.

*Shembull: “S-PDT-B1S” (Brokeri i parë senior i Prodata)*

Bursa ALSE përcakton statusin e Brokerit (Senior ose Junior) dhe aksesin që do të ketë në sistemin ETS sipas kërkesës nga Anëtari për llogari të të cilit do të punojë ky Broker.

#### **Neni 10**

##### **Mënyra e Kodifikimit të Emetuesve**

Emetuesit të cilët do të listojnë titujt e tyre në ALSE do të kodifikohen në sistemin ETS sipas mënyrës së përcaktuar në Nenin 4 të kësaj Rregulloreje.

Konkretisht **“Kompania”** do të kodifikohet **“KMP”** ku këto shkronja do të përfaqësojnë shkurtimin e markës tregtare të subjektit.

*Shembull: Kompania Balfin do të kodifikohet “BLF”.*

## **KAPITULLI III KODIFIKIMI I TITUJVE**

#### **Neni 11**

##### **Kategoritë e Titujve**

Kodifikimi i titujve që do të listohen në Bursën ALSE do të ndahet në dy grupe kryesore si më poshte:

##### **1) Titujt e Borxhit**

- a) Tituj Borxhi Publik Afashkurtër të emtuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë të Republikës së Shqipërisë (Bonot e Thesarit 3, 6 dhe 12 mujore)
- b) Tituj Borxhi Publik Afatgjatë të emtuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë të Republikës së Shqipërisë (Obligacionet e Thesarit 2, 3, 5, 7, 10 vjecare ose me afat maturimi më të gjatë)
- c) Tituj Borxhi Publik të emtuar nga Pushteti Vendor (Obligacionet Bashkiake)
- d) Tituj Borxhi Privat Afatshkurtër të emtuar nga Kompanitë (Letrat Tregtare)
- e) Tituj Borxhi Privat Afatgjatë (Obligacionet e Korporatave)
- f) Tituj të tjerë të Borxhit

##### **2) Titujt e Kapitalit**

- a) Aksionet

## Neni 11/1

### Struktura e Kodifikimit të Titujve

Struktura e kodifikimit të titujve në Bursën ALSE do të përbëhet nga 5 pjesë si më poshtë vijon:

- 1) Pjesa e parë do të përmbajë kodin e emetuesit sic përcaktohet në rregullat e Nenit 10
- 2) Pjesa e dytë do të përmbajë kodin e instrumentit sic përcaktohet në Nenet e kodifikimit të titujve në vijim.
- 3) Pjesa e tretë do të përmbajë afatin e maturimit të titujve (në varësi të kohës së tyre të maturimit)
- 4) Pjesa e katërt do të përmbajë numrin rëndor të tranzhit të emetuar  
Pjesa e pestë do të përmbajë simbolin e valutës së huaj në të cilën do të emetohet titulli (kjo pjesë do të aplikohet nëse titulli emetohet në valutë të huaj)

**Shënim:** Ky parim nuk do të aplikohet për titujt të cilët do të emetohen nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

## Neni 12

### Kodifikimi i Titujve të Borxhit

Titujt e Borxhit të cilët do të listohen në ALSE do të kodifikohen me mbi 7 karaktere të cilët do të përbëhen nga shkronja, numra dhe simbole.

- 1) Tituj të Borxhit të emetuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë së Republikës të Shqipërisë - kodifikimi i tyre do të përbëhet nga dy pjesë, ku pjesa e parë do të japë informacion rreth llojit të Titullit dhe maturimit të tij dhe pjesa e dytë do të tregojë numrin e ankandit me të cilin është emetuar në tregun primar dhe simbolin ndërkombëtar të monedhës në qoftë se është e ndryshme nga monedha vendase(ALL).

**a) Tituj Borxhi Publik Afatshkurtër** - Konkretisht një Bono Thesari do të kodifikohet si më poshtë:

- Kodi i plotë "TBn-1234",
- **TB** - nënkupton shkurtim për Treasury Bills (Bono Thesari),
- **n** - nënkupton afatin e maturimit në këtë rast të shprehur në muaj (3,6 ose 12 muaj),
- **1234** - tregon numrin e ankandit të këtij titulli të emetuar në tregun primar.

*Shembull: TB6-1054. (Bono Thesari 6 – mujore me numer ankandi 1054).*

**b) Tituj Borxhi Publik Afatgjatë** - Konkretisht një Obligacion Thesari do të kodifikohet si më poshtë:

- Kodi i plotë do të jetë "NFVn-1234",
- **N** - nënkupton shkurtimin e termit Note (Obligacion),
- **F** - nënkupton normën e interesit fiks (Obligacion me interes fiks),
- **V** - nënkupton normën e interesit variabël (Obligacion me interes të ndryshueshëm),
- **n** - nënkupton afatin e maturimit të këtij Titulli në këtë rast të shprehur në vite,
- **1234** - tregon numrin e ankandit të këtij titulli të emetuar në tregun primar,
- \$(Dollar), €(Euro), £ (Paund) – në rast të emetimit në monedhë të huaj.

*Shembull: NF5-8037 (Obligacion me interes fiks 5 vjecar) ose NV3-1849 (Obligacion me interes të ndryshueshëm 3 vjecar).*

*Shembull në monedhë të huaj: NF5-8037€ (Obligacion me interes fiks 5 vjecar i emetuar në euro) ose NV3-1849\$( Obligacion me interes të ndryshueshëm 3 vjecar i emetuar në dollar).*

## **2) Tituj të Borxhit të emetuar nga Pushteti Vendor**

Kodifikimi i Titujve të Borxhit të emetuar nga Pushteti Vendor do të përbëhet nga më shumë se 7 karaktere ( shkronja, numra dhe simbole). Kodifikimi për një titull të emetuar nga Pushteti Vendor do të jetë si më poshtë:

- Kodi i plotë do të jetë **“BTR-MNBnyN”**,
- **B** - nënkupton fjalën **“Bashki”**,
- **TR** - në këtë rast qytetin e Tiranës,
- **MNB** - nënkupton termin **“Municipal Bond”** (Obligacion Bashkiak),
- **n** - nënkupton afatin e maturimit të këtij Titulli në këtë rast të shprehur në vite,
- **y** - (Year) nënkupton që afati i maturimit është shprehur në vite meqenëse është titull afat – gjatë,
- **N** - është numri rendor i transhit të emetuar,
- \$(Dollar), €(Euro), £ (Paund) – në rast të emetimit në monedhë të huaj.

*Shembull: “BTR – MNB4y1” (Obligacion 4 vjecar i emetuar nga Bashkia Tiranë),*

*Shembull në monedhë të huaj: “BTR – MNB4y1€” (Obligacion 4 vjecar i emetuar në euro nga Bashkia Tiranë)*

## **3) Tituj të Borxhit të emetuar nga Kompanitë**

**a)** Kodifikimi i Titujve të Borxhit të emetuar nga kompanitë do të përmbajë më shumë se 7 karaktere (shkronja, numra dhe simbole):

- Kodi i plotë do të jetë **“ABC-CBnyN”**,
- **ABC** - do të nënkuptojë shkurtimin e emrit të kompanisë e cila do të emetojë këtë titull,
- **CB** - nënkupton **“Corporate Bond”** (Obligacione Korporative),
- **n** - është afati i maturimit të këtij titulli borxhi,
- **y** - (Year) nënkupton që afati i maturimit është shprehur në vite meqenëse është titull afat-gjatë,
- **N** - është numri rendor i transhit të emetuar,
- \$(Dollar), €(Euro), £ (Paund) – në rast të emetimit në monedhë të huaj.

*Shembull: “DGT – CB7Y1” (Obligacion 7 vjecar i emetuar nga Digialb),*

*Shembull në monedhë të huaj: “DGT – CB7Y1£” (Obligacion 7 vjecar i emetuar në paund nga Digialb)*

## **4) Obligacione Hipotekore (Mortgage Bonds)**

Kodifikimi i Obligacioneve Hipotekore do të përmbajë më shumë se 7 karaktere (shkronja, numra dhe simbole) dhe do të kodifikohet si më poshtë:

- Kodi i plotë do të jetë **“ABC-MGBnyN”**,
- **ABC** - do të nënkuptojë shkurtimin e emrit të kompanisë e cila do të emetojë këtë titull,
- **MGB** nënkupton **“Mortgage Bond”** (Obligacione Hipotekore),
- **n** - është afati i maturimit të këtij titulli borxhi,
- **y** - (Year) nënkupton që afati i maturimit është shprehur në vite meqenëse është titull afat-gjatë,
- **N** - është numri rendor i transhit të emetuar,
- \$(Dollar), €(Euro), £ (Paund) – në rast të emetimit në monedhë të huaj.



*Shembull: "IUT-MGB3Y1" (Obligacion Hipotekor i emetuar nga IUTE Credit).*

*Shembull në monedhë të huaj: "IUT-MGB3Y1\$" (Obligacion Hipotekor i emetuar në dollar nga IUTE Credit).*

#### **5) Obligacione të Konvertueshme**

Kodifikimi i Obligacioneve të Konvertueshme do të përmbajë më shumë se 7 karaktere (shkronja, numra dhe simbole) dhe do të kodifikohet si më poshtë:

- Kodi i plotë do të jetë "**ABC-CVBnyN**",
- **ABC** - do të nënkuptojë shkurtimin e emrit të kompanisë e cila do të emetojë këtë titull,
- **CVB** nënkupton "**Convertible Bonds**" (Obligacione të Konvertueshme),
- **n** - është afati i maturimit të këtij titulli borxhi,
- **y** - (Year) nënkupton që afati i maturimit është shprehur në vite meqënëse është titull afat-gjatë,
- **N** - është numri rendor i transhit të emetuar,
- \$(Dollar), €(Euro), £ (Paund) – në rast të emetimit në monedhë të huaj.

*Shembull: "CRE-CVB5y" (Obligacione të Konvertueshme të emetuara nga Credins Bank).*

*Shembull në monedhë të huaj: "CRE-CVB5y\$" (Obligacione të Konvertueshme të emetuara në dollar nga Credins Bank).*

#### **6) Tituj Borxhi Afatshkurtër të emetuara nga Kompanitë (Dëftesë Tregtare)**

Kodifikimi i Letrave Tregtare të emetuara nga kompanitë do të përmbajë më shumë se 7 karaktere (shkronja, numra dhe simbole) do të kodifikohen:

- Emri i plotë do të jetë "**ABC-CPnmN**",
- **ABC** - do të nënkuptojë shkurtimin e emrit të kompanisë e cila do të emetojë këtë titull,
- **CP** - që nënkupton "**Commercial Paper**" (Dëftesë Tregtare),
- **n** - është afati i maturimit të këtij titulli borxhi (3, 6, 9 mujore),
- **m** - (month) nënkupton që afati i maturimit është shprehur në muaj meqënëse është titull afatshkurter,
- **N** - është numri rendor i transhit të emetuar,
- \$(Dollar), €(Euro), £ (Paund) – në rast të emetimit në monedhë të huaj.

*Shembull: "BLF-CP6m1" (Dëftesë Tregtare 6 mujore e emetuar nga BALFIN Group).*

*Shembull në monedhë të huaj: "BLF-CP6m1\$" (Dëftesë Tregtare 6 mujore e emetuar në dollar nga BALFIN Group).*

### **Neni 13**

#### **Mënyra e kodifikimit të Titujve të Kapitalit**

Titujt e Kapitalit që do të listohen në Bursën ALSE do të kodifikohen me mbi 7 karaktere (shkronja, numra dhe simbole).

- Emri i plotë do të jetë "**KMP-SHN**",
- **KMP** - do të përfaqësojë shkurtimin e emrit të vëzhguesit në këtë rast "**Kompania**",
- **SH** - nënkupton shkurtimin e emrit "Shares" (Aksione),
- **N** - nënkupton numrin rendor të transhit të aksioneve.

*Shembull : "CRED-SH1" (Aksione të emetuara nga Credins Bank).*

## KAPITULLI IV KODIFIKIMI I LLOGARIVE TË TREGTIMIT

### Neni 14

#### Kodifikimi i Llogarive të Tregtimit

Të gjithë Anëtarët që do të tregtojnë në sistemin ETS, bazuar në të dhënat e plotësuar në Formularin e Anëtarësimit të Bursës ALSE, do të mund të përdorin dy tipe llogarish për të vendosur urdhëra në sistemin ETS.

Llojet e llogarive që mund të përdorin janë si më poshtë:

- a) **Llogaria e Klientit** (Client) – kjo llogari do të përdoret për vendosjen në sistemin ETS të urdhrave dhe kryerjen e transaksioneve nga Brokëri për llogari të klientëve të Anëtarit që përfaqëson. Kjo llogari në sistemin ETS do të kodohet dhe identifikohet me gërmën “**C**”
- b) **Llogaria Vetjake** (House) – kjo llogari do të përdoret për vendosjen në sistemin ETS të urdhrave dhe kryerjen e transaksioneve nga Brokëri për llogari të Anëtarit që përfaqëson. Kjo llogari në sistemin ETS do të kodohet dhe identifikohet me gërmën “**H**”

Çdo llogari (klienti dhe/apo vetjake) do të shoqërohet me një numër llogarie unike e cila është e njëjtë me llogarinë e hapur nga Anëtarët pranë Depozitarëve të titujve të përcaktuar nga ALSE, në të cilën janë depozituar titujt e zotëruar nga klientët dhe/apo vetë anëtarit.

## KAPITULLI V KODIFIKIMI I SKEDULIT TË ORARIT TË TREGTIMIT

### Neni 15

#### Kodifikimi i skedulit të tregtimit

Skeduli i tregtimit do të përcaktojë oraret kur do të tregtohet në sistemin ETS të Bursës ALSE. Skedulet do të ndahen sipas metodës së tregtimit të përcaktuar në Rregulloren e Bursës ALSE.

- a) **Metoda e Vazhdueshme** - Titujt tregtohen nëpërmjet përputhjes së vazhdueshme të urdhrave në anët e kundërta të Librit Qëndror të Urdhrave (COB).

Fazat përgjatë së cilave do të mund të tregtohet në sistemin ETS sipas Metodës së Vazhdueshme dhe kodifikimi i tyre do të jetë si vijon:

- OFF1- do të nënkuptojë fazën e parë të tregtimit jashtë burse (Off-Exchange 1)
- PO – do të nënkuptojë fazën para tregtimit (Pre-Opening)
- O – do të nënkuptojë fazën kryesore të tregtimit (Opening)
- OFF2 - do të nënkuptojë fazën e dytë të tregtimit jashtë burse (Off-Exchange 2)
- C – do të nënkuptojë fazën e mbylljes (Closed)

Gërma “**CM**” në sistemin ETS do të identifikojë titujt e listuar për t'u tregtuar në Metodën e Vazhdueshme.

- b) **Metoda e Ankandit** - Titujt tregtohen nëpërmjet procedurave të thirrjes së ankandit pas një periudhe gjatë së cilës urdhrat janë akumuluar në COB pa u ekzekutuar.

Fazat e përgjatë së cilave do të mund të tregtohet në Metodën e Ankandit dhe kodifikimi i tyre do të jetë si vijon:

- OFF1- do të nënkuptojë fazën e parë të tregtimit jashtë burse (Off-Exchange 1)
- PO – do të nënkuptojë fazën e thirrjes (Pre-Opening)
- PT – do të nënkuptojë fazën Pas Tregtimit (Post-Trade)
- OFF2 - do të nënkuptojë fazën e dytë të tregtimit jashtë burse (Off-Exchange 2)
- C – do të nënkuptojë fazën e mbylljes së tregtimit (Closed)

Ekzistojnë tre mënyra për të tregtuar një titull në ankand dhe secili prej tyre do të jetë i kodifikuar si vijon:

- Ankandi Fiks – Auction Fix
- Ankandi një në një – Auction 1:1
- Ankandi një në shumë –Auction 1:N

Procedurat teknike të organizimit të këtyre ankandëve përcaktohen në udhëzime të vecanta të Bursës ALSE.

## KAPITULLI VI KODIFIKIMI I ÇERTIFIKATAVE TË PËRDORUESVE TË SISTEMIT ETS

### Neni 16

#### Kodifikimi i Çertifikatës së Anëtarësimit në Bursën ALSE

Kodifikimi i Çertifikatës së Anëtarësimit në Bursën ALSE do të përbëhet nga këto elementë:

- **Vula Digjitale** – në të cilën do të jepet informacioni i vitit të emetimit të kësaj Çertifikate Anëtarësimi,
- **Numri serial : n/yy**
- **n** do të nënkuptojë numrin rëndor i cili tregon rradhën e Anëtarësimit në Bursën ALSE, dhe
- **yy** - tregon dy shifrat e fundit të vitit kur Anëtari e ka marrë këtë Çertifikatë

### Neni 17

#### Kodifikimi i Çertifikatës së Përdoruesit të Sistemit ETS

Kodifikimi i çertifikatës së Përdorimit të Sistemit ETS nga Brokëri do të ketë këto elementë:

- **Numri serial : nn/N** ku:
- **nn** - nënkupton numrin rendor të anëtarit për të cilin brokëri operon, dhe
- **N** - nënkupton numrin rendor të brokërit.

### Neni 18

#### Kodifikimi i Çertifikatës së Mbikëqyrësit të Tregut

Në çertifikatën e emetuar për Mbikëqyrësit e Tregut do të jenë këto elementë:

- **Numrin serial: A/nn** ku:
- **A** - do të nënkuptojë termin “**Autoritet**”, dhe
- **nn** do të nënkuptojë numrin rendor të personit i cili do të mbikëqyrë.

### **Neni 19**

#### **Kodifikimi i Çertifikatës së Vëzhguesve të Tregut**

Në çertifikatën e emetuar për Vëzhguesit e Tregut do të jenë këto element:

- **Numrin serial: O/nn** ku:
- **O** - do të nënkuptojë termin "**Vëzhgues**" (Observer), dhe
- **nn** do të nënkuptojë numrin rendor të personit i cili do të mbikëqyrë.

### **Neni 20**

#### **Hyrja në Fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë pas miratimit nga Këshilli Mbikëqyrës i ALSE.

**KRYETARI**  
**HYSEN ÇELA**